

PROFESIONET E LIRA DHE ROLI I TYRE NË PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE

RREZIKU I PASTRIMIT TË PARAVE. PSE PARATË E VEPRIMTARIVE KRIMINALE NUK DUHET TË FUTEN NË RRJEDHËN E BIZNESIT TË LIGJSHËM? VEPRIMET DHE MASAT E ANËTARËVE TË PROFESIONIT NË LUFTËN KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Prof. Dr. Hysen ÇELA*
Fakulteti i Ekonomisë,
Universiteti i Tiranës

Në kuadër të përafrimit të legjislacionit me EU *acquis*, dhe me rekomandimet ndërkombëtare të Grupit të punës për veprimin financiar (FATF), në maj të vitit 2008, u miratua Ligji nr. 9917, datë 19.05.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i cili u pasua me krijimin e institucionit përgjegjës dhe rritjen e kapacitetit të tij dhe bashkërendimin me të gjithë autoritetet e tjera ligjzbatuese të vendit. Ndryshimet ligjore të viteve 2017 dhe 2021, e kanë sjellë kuadrin ligjor në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, më afër me direktivën europiane për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Moneyval, Komiteti i Ekspertëve të Këshillit të Europës, që vlerëson pajtueshmërinë me standardet e FATF, në raportin e vitit 2018, ka vlerësuar se Shqipëria ka një kuptim të arsyeshëm në lidhje me rreziqet e pastrimit të parave në ekonominë formale dhe ka ndërmarrë hapa për të adresuar rekomandimet e FATF. Megjithatë, për shkak të rreziqeve të shtuara që lidhen me korrupsionin, ekonominë informale, etj., vendi ynë ndodhet në një proces të monitorimit të thelluar (*enhanced follow-up*). Dy raportet e fundit të këtij monitorimi, ndërsa rivlerësojnë pozitivisht punën e bërë, nënvizojnë përsëri se disa rekomandime nuk janë adresuar plotësisht dhe vlerësimi për to, vijon të jetë “pjesërisht në pajtueshmëri”, si në aspektin legjislativ, ashtu edhe atë të zbatimit.

Në kuadër të njohjes, ndërgjegjësimit publik dhe rëndësisë që ka adresimi i këtij fenomeni, në vijim do të përpiqem të trajtoj shkurtimisht rolin që duhet të luajnë disa nga subjektet e ligjit/kuadrit kundër pastrimit të parave, për të paran-

daluar dhe për të penguar këtë fenomen negativ dhe shumë të dëmshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Natyrisht, kategoritë e subjekteve të ligjit janë të shumta, duke përfshirë, në funksion të nivelit të rrezikut të pastrimit të parave, të gjithë subjektet financiare të rregulluara, një numër të madh të bizneseve jofinanciare, si dhe individët dhe profesionet e lira. Megjithatë, fokusi i trajtimit do të jenë profesionet e lira (kontabilistët, audituesit, noterët, avokatët, këshilltarët tatimorë, etj.), të cilët asistojnë, lehtësojnë dhe bëjnë të mundur komunikimin dhe kryerjen e transaksioneve për një numër jo të vogël të entiteteve të biznesit.

PARANDALIMI I PASTRIMIT TË PARAVE, NJË ÇËSHTJE QË MERITON VËMENDJE TË VEÇANTË

Origjina e termit “pastrim i parave” e ka zanafillën në praktikën e Al Capone-s, të blerjes së qendrave të pastrimit lavanderi në qytetin e Çikagos, në funksion të pastrimit të parave të siguruar nga veprimtaria e paligjshme e shitjes së alkoolit, të cilat “pastroheshin” përmes bashkimit dhe raportimit të tyre si të ardhura nga veprimtaria e zakonshme e larjes dhe pastrimit. Grupet e Mafies, të cilat nisën me “pastrimin” e parave të siguruar nga shitja e alkoolit, (një veprimtari e ndaluar për kohën), vite më vonë, e zgjeruan më tej aktivitetin e tyre, duke përfshirë në procesin e pastrimit edhe të ardhurat nga veprimtari të tjera kriminale, siç ishin droga, trafiku i qenieve njerëzore dhe akte të tjera kriminale.

Prej viteve ‘20 të shekullit të kaluar, kur fenomeni i pastrimit të parave doli në skenë për herë të parë, e deri në ditët tona, kanë ndodhur shumë zhvillime. Pastrimi i parave është zgjeruar, dhe

sofistikuar më tej, gjë që ka detyruar shumë qeveri në vende të ndryshme të bashkërendojnë përpjekjet e tyre për adresimin e duhur dhe luftën kundër tij. Çështja e pastrimit të parave është trajtuar edhe nga një numër i madh organizmash ndërkombëtare, të cilat kanë vënë në lëvizje instrumente dhe mekanizma parandaluese të shumëllojshme. Shumat e parave që u nënshtrohen pastrimit mund të vijnë nga aktivitete kriminale, individuale ose të organizuara; nga veprimtari të paligjshme; nga ryshfeti që marrin zyrtarët publikë të korruptuar; si dhe nga një gamë e gjerë veprimtarish të



tjera joligjore të entiteteve të biznesit publik e privat.

Shqipëria nuk mund të jetë e imunizuar nga krimi dhe as nga pastrimi i parave që i shoqëron veprimtaritë kriminale. Rastet e praktikave të pastrimit të parave të zbuluara nga media dhe organet ligjzbatuese, kanë detyruar autoritetet shtetërore të rishikojnë, herë pas here, kuadrin ligjor dhe rregullator, përfshirë masat përkatëse parandaluese. Përveç hartimit të një kuadri ligjor modern, i cili duket se i përgjigjet nivelit dhe shkallës së përhapjes së fenomenit të pastrimit të parave, janë ngritur dhe funksionojnë institucionet përgjegjëse dhe është institucionalizuar një proces permanent që mundëson reflektimin në kohë të të gjithë ndryshimeve të kuadrit ndërkombëtar, siç janë standardet dhe metodologjia e FATF, por edhe direktivat e BE-së. Sidoqoftë, si në çdo fushë tjetër, parandalimi i pastrimit të parave, nuk lidhet aq me cilësinë e kuadrit ligjor, sa lidhet me cilësinë e zbatimit të kërkesave ligjore e rregullatore dhe veçanërisht, më shkallën e ndërgjegjësimit të opinionit publik për këtë fenomen dhe pasojat negative të tij, i cili gjithnjë e më shumë priret të jetë një çështje globale.



Çfarë kuptohet me pastrim parash?

Pastrimi i parave është një proces që përdoret, nga zotëruesit e parave të siguruara me burime të paligjshme, për t'i kthyer ato në fonde që duken se janë të ligjshme dhe, si të tilla, të mund të përdoren normalisht në jetën e përditshme, njëlloj siç përdoren edhe paratë e veprimtarisë së ligjshme të biznesit. Duke legjitimuar të ardhurat e krimit, pastrimi i parave stimulon bandat e drogës, trafikantët e qenieve njerëzore dhe kriminelët e tjerë, për të zgjeruar më tej veprimtaritë tyre, në funksion të sigurimit në vazhdimësi të shumave të tjera të paligjshme, të konsiderueshme. Vlerësohet se shuma vjetore e pastrimit të parave në nivel global, i kalon 1 trillion dollarët.

Si funksionon pastrimi i parave?

Për t'u pastruar, të ardhurat e veprimtarive të paligjshme dhe kriminale, në hapin e parë duhet të shpëputen nga veprimtaritë e krimit, dhe kjo bëhet përmes vendosjes, shtresëzimit/copëtim-it dhe integritetit të tyre në sistemin financiar të ligjshëm. Një proces i tillë kërkon pjesëmarrjen e shumë aktorëve dhe ekzistencën e disa rrethanave e faktorëve, duke nisur nga bankat, bizneset jofinanciare dhe profesionistët.

Në hapin e parë, vendosja e fondeve të paligjshme në sistemin financiar mund të bëhet duke i ndarë shumat e mëdha të parave në shuma më të vogla, dhe duke i depozituar ato drejtpërdrejt në llogari bankare, ose përmes blerjes së një sërë instrumentesh monetare të cilat më pas, mund të mblidhen dhe depozitohen në llogari të ndryshme të hapura për këtë qëllim në vende të ndryshme. Pronarët e parave të paligjshme mund të shfrytëzojnë mundësitë që krijon globalizimi dhe lëvizja e lirë e njerëzve, mallrave dhe mjeteve financiare. Nder metodat që mund të përdoren më shpesh janë konvertimi i monedhave të huaja në monedha të tjera, transporti i parave cash, depozitat në para në bankë, etj.

Rasti më i fundit, i përmendur në median tonë, kur një zotërues i parave të depozituara në Zvicër tentoi të depozitonte një shumë të konsiderueshme parash në Shqipëri, dëshmon se operacione të tilla ndodhin, dhe se ato mund të përsëriten. Në hapin e dytë, të shtresëzimit, pastruesi i parave mund të angazhohet në një seri transaksionesh, siç mund të jenë për shembull, konvertimi i parave apo lëvizja/transferimi i tyre,

me qëllim që ato të largohen nga burimi kryesor (veprimtaria kriminale apo e paligjshme që i ka prodhuar). Paratë mund të përdoren për të blerë dhe për të shitur instrumente të investimit. Pastruesi mund t'i ndajë paratë në llogari bankare të hapura në banka dhe vende të ndryshme, kryesisht në ato juridiksione që nuk bashkëpunojnë në investigimet ndërkombëtare kundër pastrimit të parave. Në disa raste, këto veprime mund të maskohen me "pagesa" për mallra ose shërbime fiktive, duke ju dhënë, në këtë mënyrë, pamje legjitime parave të arkëtuara. Metodatat më të zakonshme të shtresëzimit janë transfertat bankare; tërheqjet e parave nga llogaritë bankare për pagesa të ndryshme; ndarjet dhe bashkimet e llogarive, etj.

Në hapin e tretë, paratë e paligjshme hyjnë në ekonominë legjitime. Ato mund të investohen në blerjen e pasurisë së paluajtshme, në blerjen e mallrave dhe sendeve të luksit, por edhe në veprimtari të ndryshme të biznesit. Disa nga metodatat që përdoren janë kreditë ose kontratat e huave fiktive në banka të ndryshme, maskimi i pronësisë së aktiveve dhe bizneseve, përdorimi i transaksioneve me palë të treta, përfshirja në tendera dhe fitimi i kontratave publike nëpërmjet ryshfetit dhe korrupsionit të zyrtarëve publikë, etj.

LUFTA KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE – ROLI I PROFESIONIT KONTABËL

Përtej çdo dyshimi, vlen të nënvizohet që në fillim, se roli i anëtarëve të profesionit kontabël dhe profesionëve të tjera që japin shërbime për biznesin, si subjekte të kuadrit rregullator të luftës kundër pastrimit të parave, është mjaft i madh dhe shumë i rëndësishëm. Ai shkon përtej thjeshtë, respektimit prej tyre të kërkesave ligjore apo rregullatore të zbatueshme. Kontributi i anëtarëve të profesionit nuk mund të jetë një ushtrim i thjeshtë pajtueshmërie, d.m.th., vetëm kujdesi për respektimin formal të disa kërkesave detyruese, që parashikohen në ligjin apo rregullat për parandalimin e pastrimit të parave. Krimi ekonomik, që përfshin edhe pastrimin e parave, ka ndikim të madh te siguria e qytetarëve. Njëlloj si erozioni dëmton mjedisin, pastrimi i parave gërryen shoqërinë; ai mbjell pasiguri dhe paqëndrueshmëri ►►

◀◀ sociale e politike, pa të cilat prosperiteti i çdo vendi, do të vihej në rrezik. Investimet e parave me burime të paligjshme në prona të paluajtshme dhe të luajtshme, prishin rrjedhën normale të biznesit, minojnë konkurrencën në treg dhe nxisin pabarazinë. Droga dhe dhuna që e shoqëron atë, trafikun i qenieve njerëzore ose “skllavëria moderne” dhe traumat sociale bashkëshoqëruese, janë disa nga llojet e veprimtarive kriminale që prodhojnë para, të cilat “kanë nevojë të ngutshme” të pastrohen. Kriminelët përdorin të gjithë mundësitë për të përfutur, që nga gjobëvënia, joshja dhe përdorimi i individëve lehtësisht të cenueshëm, frikësimi përmes përdorimit të drogës dhe dhunës, etj. Në këtë mënyrë, në funksion të qëllimit - krijimit të burimeve financiare të paligjshme - ata dëmtojnë strukturën sociale të shoqërisë. Profesionistët kontabël, sikurse është përcaktuar në Kodin e Etikës IESBA të IFAC-ut, ka si mision kryesor, kryerjen e shërbimeve profesionale cilësore, me kompetencën e kërkuar, me integritet, objektivitet dhe pavarësi e paanshmëri, në funksion të qëllimit kryesor – mbrojtjes së publikut dhe të interesit publik. Përbushja e këtij angazhimi, kërkon që anëtarët e profesionit të kontribuojnë për sigurinë e shoqërisë dhe veçanërisht, për qëndrueshmërinë e saj sociale, pa të cilën, asnjë arritje e deritanishme nuk mund të mbrohet dhe asnjë arritje e mëtejshme e nesërme, nuk do të mund të garantohet. Në rolin e tyre të “portierit”, apo mbrojtësit të sistemit financiar, profesionistët kontabël mund të konsiderohen hallka e parë mbrojtëse, apo pengesa më serioze, që fondet e krijuara nga veprimtaritë kriminale dhe të paligjshme, të gjejnë terrenin dhe mundësitë për “t’u pastruar” dhe për t’u futur në ekonominë e ligjshme.

Rreziku i pastrimit të parave. Pse paratë e veprimtarive kriminale nuk duhet të futen në rrjedhën e biznesit të ligjshëm?

Përpara anëtarëve të profesionit, pastrimi i parave paraqet shumë rreziqe, të cilat, sipas një publikimi të përbashkët midis IFAC dhe ICAEW, mund të grupohen në tre kategoritë e mëposhtme: Anëtarët e profesionit kontabël të mund të përdoren nga përfaqësuesit grupeve kriminale për të kryer, për llogari të këtyre grupeve, veprimtari të pastrimit të parave. Për shembull, profesionistët kontabël mund të mbajnë në llogarite

e tyre bankare, të ardhura të grupeve të ndryshme të jashtëligjshme, të kryejnë veprime sipas porosisë së këtyre grupeve, apo të bëhen palë në marrëveshje që synojnë fshehjen/maskimin e pronësisë së përfituesve të të ardhurave kriminale. Profesionistët kontabël të mund të përdoren nga grupet kriminale si mjete apo instrumente për të lehtësuar pastrimin e parave, kur një gjë e tillë kryhet nga persona të tjerë. Për shembull, profesionistët mund të ndihmojnë në krijimin e entiteteve të biznesit, të cilat paraqesin rrezik për përfshirje në pastrimin e parave. Gjithashtu, ata mund të ndërmjetësojnë, përmes referimit apo lidhjes së grupeve që synojnë pastrimin e parave me këshilltarë biznesi “të suksesshëm”. Angazhime të tilla nuk janë edhe aq “të vështira”, në ekonominë në tranzicion dhe në vendet në zhvillim, siç është edhe vendi ynë, ku veprimtaritë e paligjshme, nuk janë aq të sofistikuara dhe publiku nuk është i ndërgjegjësuar për pasojat negative. Një ekonomi informale mjaft e përhapur është një mundësi e mirë për të krijuar inpute për procesin e pastrimit. Kooperimi midis zyrtarëve publikë dhe “pronarëve” të parave të krimit dhe të bizneseve, lehtëson pastrimin e parave dhe mundëson “transferimin” e parave të paligjshme nga grupet kriminale te zyrtarët publikë të korruptuar. Anëtarët e profesionit rrezikojnë dëmtimin e reputacionit të tyre. Duke u përfshirë drejtpërdrejt apo tërthorazi në pastrimin e parave, profesionistët mund të vuajnë pasojat ligjore dhe etike. Mungesa e kujdesit, mosaplikimi i masave të vigjilencës së duhur, mospërm-

bushja e detyrimeve të raportimit kur klientët e tyre janë të përfshirë ose ka mundësi të përfshihen në pastrimin e parave, janë rreziqe serioze të dëmtimit të reputacionit profesional.

Veprimet dhe masat e anëtarëve të profesionit në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

Profesionistët kontabël, bazuar në kuadrin kombëtar dhe ndërkombëtar të luftës kundër pastrimit të parave, duhet të hartojnë rregulla të brendshme për adresimin në kohë dhe në mënyrë efektive të të gjitha çështjeve që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave. Kërkesa kryesore për një anëtar të profesionit, sikurse edhe për subjektet e tjera që kanë rol në këtë fushë, është ushtrimi i vigjilencës së duhur ndaj klientit. Ai duhet të njohë dhe të kuptojë identitetin dhe aktivitetin e biznesit të klientit, të cilit i shërben, me qëllim që të vlerësojë shkallën e rrezikut, që klienti i tij të rezultojë i përfshirë, ose rrezikun që ai të mund të përfshihet në të ardhmen, në pastrim të parave të veprave kriminale. Gjithashtu, ai duhet të vlerësojë rrezikun që klienti po synon të përfshijë profesionistin në pastrimin e parave, për shembull, duke i kërkuar atij të ndihmojë në disa nga hallkat e këtij procesi.

Kjo kërkesë bëhet edhe më e fortë kur klientët, ose përfaqësuesit e tyre, janë persona të ekspozuar politikisht (PEP), d.m.th., individë, të cilëve ju janë besuar funksione të rëndësishme publike, si për shembull, politikanët ose drejtuesit e organeve të administratës qendrore





e vendore, drejtuesit e organizatave të tjera shtetërore, etj. Në këto raste, profesionistëve kontabël ju kërkohet të tregojnë kujdes shtesë, si për individët e ekspozuar, ashtu edhe për anëtarët e familjeve të tyre, për shkak të rrezikut të pastrimit të parave që vijnë nga korrupsioni. Ekziston një rrezik i shtuar që burimi i mjeteve financiare të cilat investohen, të ketë lidhje me pozicionin e tyre politik aktual, ose të mëparshëm. Rastet e përfshirjes në korrupsion të zyrtarëve të lartë në vendet në tranzicion, siç është Shqipëria, janë shumë të përhapura.

Veç njohjes së klientit dhe vlerësimit të rrezikut të tij, profesionisti kontabël, duhet të kryejë veprimtari të vazhdueshme monitoruese, si për klientët e rinj, ashtu edhe ata ekzistues, të përditësojë kontrollet dhe njohjen e siguruar, veçanërisht në rastet kur pronësia ose aktiviteti i klientit kanë pësuar ndryshime të mëdha.

Në vendin tonë, por edhe në shumë juridiksione të tjera, kërkesat e vigjencës së duhur dhe të monitorimit janë pjesë e obligimeve profesionale dhe rregullatore. Subjektet e ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, kanë detyrimin e ushtrimit të vigjencës së duhur, sipas rastit, të thjeshtë, të moderuar, apo të zgjeruar, dhe për marrjen e masave përkatëse, përfshirë monitorimin e vazhdueshëm. Profesionistët kontabël kanë detyrimin ligjor të raportojnë aktivitetet e dyshimta të pastrimit të parave tek autoriteti përgjegjës (Njësia e Inteligjencës Financiare - FIU, ose DPPP). Kërkesa për raportim të veprimtarive të dyshimta përfshihet edhe në detyrimet

profesionale. Sipas Kodit IESBA të IFAC, profesionistët kontabël duhet të veprojnë në pajtim me parimin themelor etik, sjelljen profesionale, i cili kërkon që ata të respektojnë ligjet dhe rregullat e zbatueshme, kurdoherë që marrin përsipër të kryejnë një shërbim profesional, për një klient apo punëdhënës. Seksionet 260 dhe 360 të kodit IESBA, të cilat trajtojnë papajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme (NOCLAR), përmbajnë detyrimin profesional që profesionistët kontabël të raportojnë kur ata marrin dijeni, ose kanë dyshime për papajtueshmëri me ligjet dhe rregullat, përfshirë legjislacionin për parandalimin e pastrimit të parave.

METODA E BAZUAR TE RREZIKU NJË MËNYRË EFIKASE PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE

Për një përmbushje më të mirë të detyrimeve ligjore dhe profesionale, anëtarët e profesionit kontabël, por edhe të profesioneve të tjera relevante, duhet të zbatojnë një qasje që nisat nga vlerësimi i rrezikut. Për këtë, ata duhet të identifikojnë, kuptojnë dhe vlerësojnë rreziqet e pastrimit të parave me të cilat ata ekspozohen, me qëllim zvogëlimin e tyre deri në një nivel të ulët të pranueshëm. Kjo do të thotë se ata duhet të njohin klientin, shërbimet dhe juridiksionin e zbatueshëm.

Identifikimi i rreziqeve të pastrimit të parave përfshin identifikimin e: rreziqeve të klientëve, të cilëve profesionisti kontabël ju shërben, rreziqeve të shërbimeve profesionale që ju jepen klientëve, dhe rreziqeve të juridiksionit të klientëve dhe të profesionistit. Çdo rrezik i pastrimit të parave i identifikuar, vlerësohet sa i takon mundësisë së ndodhjes dhe pasojave negative që sjell. Nisur nga niveli i vlerësuar i rreziqeve përkatëse, profesionistët kontabël përcaktojnë tërësinë e procedurave, proceseve, kontrolleve dhe masave që duhet të merren për të zvogëluar rreziqet deri në një nivel të ulët të pranueshëm.

Kur hyjnë në marrëdhënie me një klient të ri, apo japin shërbime të ndryshme për një klient ekzistues, profesionistët kontabël duhet të kenë njohuritë dhe zotësitë e duhura për të njohur dhe për të kuptuar tre zonat e mëposhtme të rrezikut të pastrimit të parave, përkatësisht:

- Rrezikun gjeografik ose të juridiksionit, i cili përfaqëson rrezikun e pastrimit të parave, me të cilin ekspozohet klienti, për shkak të juridiksionit ku operon, ose vendit nga vjen, kur është klient i huaj. Vlerësimi i kësaj kategorie të rrezikut do të kërkonte, për shembull, të mbahet parasysh niveli i perceptimit të korrupsionit në juridiksionin përkatës. Veç kësaj, me rëndësi është edhe rishikimi i kuadrit ligjor dhe rregullator për parandalimin e pastrimit të parave, të vendit nga vjen klienti. Rreziku për pastrim parash është i lartë, kur klienti apo personat që e përfaqësojnë atë, vijnë nga vende ku rastet e pastrimit të parave janë të shpeshta, kuadri ligjor është i pamjaftueshëm dhe zbatimi i tij është i dobët.

- Rrezikun e klientit, që përfaqëson rrezikun e përgjithshëm të pastrimit të parave, me të cilin ekspozohet klienti, për shkak të natyrës së veprimtarisë së tij dhe formës së organizimit të biznesit. Profesionisti duhet të ndërtojë profilin e rrezikut të klientit, i cili mund të jetë i lartë, i moderuar ose i ulët. Rreziku që klienti të fshehtë pronësinë dhe përfituesit e vërtetë me qëllim pastrimin e parave, mund të jetë i madh, në ato raste kur klienti ka strukturë organizimi komplekse, ose të pazakontë për madhësinë e tij. Në të gjitha rastet kur vlerësohet se klienti operon në një sektor me rrezik të lartë të pastrimit të parave, profesionisti mund të kalojë nga masa të thjeshta apo mesatare të vigjencës, në masa më të zgjeruara.

- Rrezikun e shërbimit – rreziku që disa produkte ose shërbime ka më shumë të ngjarë të përdoren për pastrim parash. Në çdo rast që jep një shërbim me rrezik të lartë të pastrimit të parave, ose kur ka një rrezik që mund të përfshihet në një vepër penale të lidhur me pastrimin e parave, profesionisti kontabël duhet të kryejë verifikime shtesë lidhur me produktin apo shërbimin që jep.

Prandaj, përpara se një profesionist kontabël të ofrojë një shërbim që ndryshon nga shërbimet e tij tradicionale, ose të zakonshme, apo nga produktet ekzistuese, ai duhet të vlerësojë rreziqet që shërbimi mund të përdoret për pastrimin e parave dhe të reagojë në kohën dhe mënyrën e duhur ndaj rreziqeve. ■

**Opinionet janë personale të autorit dhe nuk përbëjnë qëndrim të revistës*